

VENDIM
Nr. 891, datë 27.12.2022

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 569, DATË 17.7.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KOMPETENCAVE,
MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË BREGDETIT”, TË NDRYSHUAR**


Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

Në vendimin nr. 569, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun III/1, pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:
“4/1. Përfshihet, për sezonin turistik të vitit 2023, shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare sigurohet vetëm për bashkitë Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë, Himarë dhe Sarandë, sipas hartave që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.”.
2. Në pikën 5, të kreut III/1, fjalët “Sigurimi i ...” zëvendësohen me “Procedura e prokurimit publik për sigurimin e ...”.
3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe bashkitë Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë, Himarë dhe Sarandë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTËR
Edi Rama






































































Bashkia	Vendndodhje	Sipërfaqja	Gjatësia	Gjerësia	Fillim i Plazhit (Veri)		Mbarim i Plazhit (Jug)	
		(m2)	(m/linear)	(m)	Koordinata E	Koordinata N	Koordinata E	Koordinata N
Durrës	Gjiri i Lalzit	5,275,880	6,730	640-930	459151.21	4600734.80	459676.09	4594050.09
	Curila-Kallm	81,760	1,260	30-100	451429.89	4578075.84	451548.54	4576832.95
	Curila	140,000	1,720	30-100	451855.71	4576719.11	452677.86	4575257.30
	Plazhi i Madh	1,728,830	6,880	120-470	455699.27	4575812.64	459887.15	4570390.09
Himarë	Palasë	544,655	840	176-1900	466229.79	4449130.53	464869.13	4447984.61
	Dhërmi-Drimadhe	973,860	5,360	205-1130	465725.44	4447453.95	470001.74	4444538.52
	Jalë	164,700	865	150-350	474530.63	4443288.51	474700.49	4442547.28
	Livadh	183,920	1,280	80-1,310	476663.07	4442413.17	477032.01	4441020.93
	Himarë	133,520	1,920	55-170	478025.69	4440818.93	479058.27	4439577.59
	Llaman	33,500	190	70-580	480145.48	4439057.13	480188.04	4438402.52
	Qeparo	93,200	1,640	52-440	485056.50	4435833.35	484017.53	4435248.32
	Borsh	422,620	4,660	100-1,960	487222.29	4436658.44	489363.83	4432238.60
	Bunec	99,670	1,035	120-1,080	490505.93	4430346.48	490904.76	4429442.18
Kavajë	Lukovë	218,530	1,260	80-1,200	492726.91	4428340.45	492605.63	4426203.34
	Golem-Qerret	3,490,160	6,730	380-730	459576.01	4570519.13	458072.53	4564194.15
Sarandë	Karpen	183,000	1,300	84-185	456520.79	4561580.95	455870.81	4560420.93
	Qytet(Pllakat)	255,205	1,800	30-250	498587.10	4415988.70	500061.78	4414869.19
	Qytet	418,748	3,000	50-280	500827.45	4415541.85	502198.81	4412567.96
	Ksamil	7,890,160	7,890	100-1500	501761.71	4412876.97	500703.12	4405213.92
Rrogozhinë	Ksamil1	1,989,766	2,200	1000-1400	500586.36	4405202.54	499788.84	4402862.72
	Spille	1,829,005	7,880	30-380	454205.31	4553721.43	453783.63	4546159.69
Vlorë	Akerni	813,636	2,640	120-300	447007.59	4492780.08	447577.93	4490136.99
	Zvërnec	439,941	2,500	80-300	449813.47	4485536.65	451783.83	4483565.44
	Zvërnec 1	1,504,170	4,800	45-700	450741.05	4485435.94	454069.38	4481959.07
	Plazhi i Vjetër	666,202	2,800	125-360	454088.68	4481980.29	455751.74	4479990.82
	Lungomare-Uji i Ftohtë	998,868	4,385	60-295	456449.52	4479990.32	455945.16	4475432.62
	Radhimë-Orikum	2,301,621	10,800	50-580	455949.32	4475419.26	451144.61	4464795.97